

Gjallë apo vdekur (2:1–7)

N vitin 1974 akrobati kokëkrisur Evel Knievel bindi mijëra njerëz se mund të kapërcente kanionin e thellë mbi lumin Sneik në Áidaho (USA) mbi një motorçikletë, të pajisur me një motor shumë të fuqishëm. Rreth 20 mijë njerëz paguan për ta parë ngjarjen nga afër. Mbi një milion të tjerë blenë të drejtën për ta parë ngjarjen në një transmetim direkt televiziv.

Knievel nuk arriti ta kapërcente kanionin. Parashutua e motoçikletës të tij «fluturuese» u hap para kohe, pak pasi Knievel-i filloi kercimin. Kokëkrisuri dhe motoçikleta e tij, duke u lëkundur në ajër, ranë poshtë në tokë.

Megjithatë, Knievel-i kërceu më larg se ç' mund të kishte shkuar gjithësecili prej nesh po t'i jepte makinës me shpejtësi e të përpiquej të kapërcente kanionin. Megjithatë, edhe ai nuk mundi ta kapërcente atë.

Njerëzit ndryshojnë nga mënyra se si jetojnë. Në qoftë se i krahasojmë njerëzit me njëri-tjetrin, njëri mund të jetë më i prirur të ndihmojë të tjerët dhe t'u bëjë mirë atyre në krahasim me një tjetër. Megjithatë, kur krahasojmë, qoftë edhe njeriun më të mirë që njohim me Perëndinë e Shenjtë, ai do të jetë shumë larg Perëndisë. Asnjë njeri nuk mund të kapërcejë «kanionin» e thellë që ndan njeriun mëkatar me Perëndinë e Shenjtë.

Edhe njeriu më i mirë që mund të imagjinojmë ka nevojë për fuqinë shpëtuese të Perëndisë po aq sa ka nevojë edhe Adolf Hitleri. Po të krahasosh jetën

e të dyve, ata nuk janë njësoj mëkatarë, por janë të dy të ndarë nga Perëndia dhe njësoj të vdekur në mëkat.

Asnjë mëkatar nuk është shpirtërisht më i mirë se një mëkatar tjetër. Pa fuqinë shpëtuese të Perëndisë, anjeri nga ne nuk është më afër Perëndisë se një pijanec, një trafikant droge apo një producent filmash pornografikë. Kur je i vdekur në mëkat, je i vdekur në mëkat dhe pikë!

Lajmi i mirë është se fuqia e Perëndisë është në gjendje të bëjë për ne atë që bëri për Krishtin. Fuqia e Perëndisë ringjall të vdekurit. Këtë të vërtetë e gjejmë te Efesianëve 2:1–7: *Perëndia e demonstroi fuqinë e Tij të madhe duke i sjellë mëkatarët nga vdekja në jetë, nëpërmjet Krishtit.*

JA SI E PËRSHKRUAN PERËNDIA GJENDJEN E MËKATARËVE QË JANË LARG NGA FUQIA E TIJ

Pali u shkroi kristianëve të qytetit të Efesit:

Ai ju dha jetë edhe juve, që ishit të vdekur në faje dhe në mëkate, në të cilat keni ecur dikur, sipas ecjes së kësaj bote, sipas prijësit të pushtetit të erës, sipas frymës që vepron tani në bijtë e mosbindjes, ndërmjet të cilëve edhe ne dikur jetuam në lakmitë e mishit dhe të mendjes, dhe ishim prej natyre bij të zemërimit, ashtu si edhe të tjerët (2:1–3).

Pali na dha një përskrim të saktë të realitetit të shëmtuar në të cilin gjendej njeriu para se të vinte Krishti. Këto vargje paraqesin një situatë kaq të

tmerrshme sa që vetëm fuqia e Perëndisë mund ta kapërcejë atë. Shohim të paktën pesë pohime të rëndësishme në këto vargje.

1. *Ne ishim të vdekur* (vargu 1). Ky pohim përshkruan me pak fjalë situatën në të cilën ndodhet çdo njeri i ndarë nga Perëndia (pa Krishtin). Në këtë pozitë qëndronte edhe çdo kristian para se t'ia dedikonte jetën e tij Krishtit. Ne nuk ishim duke vdekur, të dëmtuar apo të sëmurë rëndë. Ne ishim të vdekur ndaj Perëndisë. Shpirtat tanë nuk kishin jetë. Është tragjike se si një njeri i humbur nuk e kupton se sa i vdekur është në të vërtetë. Shoku im Bobi nuk u bë kristian deri sa mbushi të tridhjetat. Një herë më tha: «Atëherë nuk mendoja se më mungonte ndonjë gjë. Jeta ime nuk më dukej aspak bosh.» Shumë prej nesh janë si Bobi. Për ditë, muaj e vite, disa prej nesh jetonin duke menduar se po e gëzonin jetën plotësisht, se po bënim një jetë me të vërtetë intensive dhe të kënaqshme duke rendur pas «kënaqësive» të ofruara nga bota përreth. Gjatë asaj kohe as që e kishim idenë se, në themel të qenies tonë, ishim plotësisht të vdekur.

2. *Ecnim sipas botës* (vargu 2). Fjala «botë» gjendet 186 herë në origjinalin greqisht të Dhjatës së Re dhe, pothuajse çdo herë që përdoret, ka kuptimin e së keqes. «Bota» është pjesa e krijimit të Perëndisë (njerëz dhe engjëj) që është kthyer kundër vullnetit të Krijuesit të vet, Perëndisë. Është pikpamja e botës që refuzon ta marrë Perëndinë me seriozitet. Kjo pikpamje jofetare e botës mbizotëron sot. Bota e sotme është e dhënë pas kënaqësisë së çastit. Gjërat më të rëndësishme në jetë për njerëzit me këto pikpamje janë seksi, ushqimi, pija, pushimet, veshja, paraja dhe kënaqësia. Librat që lexohen më shumë sot e përcjellin këtë pikpamje. Kjo pikpamje trumpetohet edhe në artin modern, në shfaqjet televizive dhe në filmat që janë aq shumë popullore sot. Pikpamja jofetare e botës e bën moralin relativ. Çfarë është e drejtë për njërin mund të jetë e gabuar për tjetrin dhe kjo, për shumë njerëz sot, është normale. (Mendon sikur dikush vriste një fëmijë të pafajshëm, sepse ishte i irrituar me padrejtësitë në botë dhe njerëz të tjerë të thoshin që vrasësi nuk është fajtor, por shoqëria që e çoi deri në atë pikë është fajtorë! Vëreni se ku të çon morali relativ!)

3. *Fuqitë e këqija na kontrollonin*. Vargu 2 thotë se ne jo vetëm që ndiqnim rrugët e botës, por edhe rrugët e «prijësit të pushtetit të erës, sipas

frymës që vepron tani në bijtë e mosbindjes». Satani është «princi i kësaj bote» (Gjoni 12:31), «princi i demonëve» (Mateu 9:34) dhe «zoti i këtij shekulli» që «ua verboi mendjet atyre që nuk besojnë» (2 Korintasve 4:4). Satani personifikon rebelimin kundër Perëndisë. Para Krishtit, ne ishim, me apo pa dashje, subjekt i ndikimit të keq të Satanit. Ne ishim preja e tij dhe asgjë s'e pengonte atë të drejtonte (shkatërronte) jetën tonë.

4. *Jetuam në lakmitë e mishit* (vargu 3a). Fjala «mish» është përkthimi i fjalës greke *sarks*. Kjo i referohet dëshirave mëkatore të njeriut. Është prirja që kemi për të bërë atë që na pëlqen, pa na vrarë ndërgjegjja, edhe pse veprimet apo dëshirat tona mund të jenë në kundërshtim me vullnetin e Perëndisë.

5. *Ishim të dënuar* (vargu 3b). Pali tha se ne ishim «prej natyre bij të zemërimit, ashtu si edhe të tjerët». Perëndia është i shenjtë dhe, si rrjedhim, nuk mund ta lërë pa e ndëshkuar mëkatin. Perëndia urren çdo mëkat, kudo dhe kurdoherë që kryhet. Fjala greke e përkthyer «zemërim» është *orgí* dhe do të thotë «reagim i fortë dhe i vazhdueshëm i Perëndisë së Shenjtë kundër çdo forme të së keqes».

Pali dha një përshkrim grafik të jetës pa Krishtin. Ne ishim të vdekur. Ishim duke ndjekur rrugët e botës. Udhëhiqeshim nga fuqitë e këqija. Plotësonim dëshirat e mishit. Ishim të dënuar para Perëndisë.

Dikush mund të thotë: «Një sekondë. Po njerëzit që jetojnë një jetë të ndershme? Ata nuk janë kriminelë. Përkundrazi, jeta e tyre është e mbushur plot me gjëra që janë për t'u lavdëruar. Si mund të përfshihen ata në këtë përshkrim?» Më pëlqen se si e shpjegon këtë John MacArthur:

Fakti që gjithë njerëzit e ndarë nga Perëndia janë mëkatarë, nuk do të thotë se të gjithë janë njëloj të këqinj. Nëzet kufoma në fushën e betejës mund të jenë në shkallë të ndryshme kalbëzimi, por ato janë njëloj të vdekura. Vdekja manifestohet në shumë forma dhe shkallë të ndryshme, por vdekja në vetvete nuk ka shkallë. Mëkati manifestohet në shumë forma e shkallë të ndryshme, por gjendja e vetë mëkatit nuk ka shkallë. Jo të gjithë njerëzit janë të këqinj në çdo gjë që bëjnë, por të gjithë dështojnë të jetojnë sipas standartit të përkryer të Perëndisë.

Le ta shikojmë tani lidhjen e kësaj të vërtete me dy ide praktike.

Së pari, *ne fillojmë ta ndjejmë nevojën për shpëtim, kur kuptojmë se çdo të thotë të jesh i humbur*. Çdo gjë për të cilën keni nevojë, mund të

realizohet nga fuqia e Perëndisë. Dhe fuqia e Perëndisë gjendet vetëm te ungjilli i Krishtit. Në qoftë se nuk keni Krishtin, jeta juaj përshkruhet shumë saktë te Efesianëve 2:1–3 dhe, mbani mend, ky përshkrim është bërë nga Perëndia vetë. Mund të mendoni se jeni të gjallë, por për Perëndinë jeni të vdekur. Disa prej jush janë të rinj dhe mendojnë se, tani për tani, nuk kanë nevojë për Perëndinë, por më vonë në jetë ndoshta mund të kenë. Disa prej jush janë kaq të zënë me punë, sa që nuk gjejnë kohë të mendojnë për Perëndinë. Disa prej jush kanë jetuar kaq gjatë sa që janë «mësuar» tashmë të jetojnë pa Perëndinë. Shikoni Biblën. Shikoni këto vargje. Ato janë pasqyra që ju tregojnë se çfarë jeni pa Perëndinë dhe ju ndihmojnë të kuptoni se sa shumë nevojë keni për Të.

Së dyti, *intensiteti i lavdërimit të Perëndisë lidhet drejtpërdrejt me të kuptuarit e asaj se çfarë jemi pa Të*. Në qoftë se bezdiseni duke adhuruar Perëndinë, atëherë nuk e keni kuptuar aspak se çfarë ka bërë Perëndia për ju. P.sh. kur mblidheni me kristianët e tjerë për adhurim, mos e lejoni veten të ndjeheni i bezdisur, por këndojini Perëndisë, lutjuni Atij, dëgjoni fjalën e Tij me adhurim dhe gëzim në zemrat tuaja. Duhet të jemi të entuziazmuar dhe të gëzuar për Zotin. Nuk do mund ta këndonim këngën «Mëshira, hiri i Perëndisë» apo këngë të tjera si kjo pa zemër, në qoftë se do ta kuptonim se çfarë ishim dikur dhe çfarë ndryshimi ka bërë Perëndia në jetën tonë. Si mund ta këndojmë këngën «Jezusi më do» pa entuziazëm dhe gëzim? Sa më shumë e kuptojmë se sa e keqe ishte gjendja jonë pa Perëndinë, aq më shumë do ta lavdërojmë Atë për ndryshimin që ka bërë në jetën tonë.

Çdo njeri mund të mësojë për gjendjen e pashpresë të mëkatarit të ndarë nga Perëndia duke lexuar përshkrimin që vetë Perëndia bën te Efesianëve 2:1–3.

PERËNDIA E SHPALOS NDRYSHIMIN QË NDODH TE MËKATARËT SI DEMONSTRIM TË FUQISË SË TIJ

Pasi tregoi gjendjen e mëkatarëve, Pali shpjegoi se çfarë ka bërë Perëndia për ta ndryshuar atë gjendje:

Por Perëndia, që është i pasur në mëshirë, për shkak të dashurisë së tij të madhe me të cilën na deshi, edhe atëherë kur ishim të vdekur në fajë, na dha jetë me Krishtin (ju jeni të shpëtuar me anë të hirit), edhe na

ringjalli me të, dhe me të na vuri të rrimë në vendet qiellore në Krishtin Jezus (2:4–7).

Ungjilli bazohet mbi fjalët «Por Perëndia». Këto fjalë na kujtojnë gjendjen tonë të tmerrshme, dështimet dhe mëkatet tona, rebelimin tonë kundër Perëndisë dhe gjendjen e humbur. Ato gjithashtu na japin një kontrast të rëndësishëm. Në sfondin e këtij dështimi shpirtëror shfaqet Perëndia, i cili është «i pasur në mëshirë» dhe «ka një dashuri të madhe me të cilën na deshi».

Vini re se çfarë ka bërë Ai:

1. *Ai «na dha jetë me Krishtin»*. Kristianët nuk janë më larg Perëndisë. Ata nuk janë më të vdekur. Jezusi është udha, e vërteta dhe jeta (Gjoni 14:6). Në Të është jeta (Gjoni 1:4). Kushdo që beson te Jezusi nuk do të humbasë, por do të ketë jetë të përjetshme (Gjoni 3:16).

2. *Ai «na ringjalli me të [Krishtin]»*. Kur ndodh kjo ringjallje? Pali shkroi:

Po a nuk e dini se ne të gjithë që u pagëzuam në Jezu Krishtin, u pagëzuam në vdekjen e tij? Ne, pra, u varrosëm me të me anë të pagëzimit në vdekje, që, ashtu si Krishti u ringjall prej së vdekurish me anë të lavdisë së Atit, kështu edhe ne gjithashtu të ecim në risinë e jetës. Sepse, nëse u bashkuam me Krishtin në një vdekje të ngjashme me të tijën, do të jemi edhe e ringjalljes së tij (Romakëve 6:3–5).

Kur e kuptoni se jeni të humbur, kur dëgjoni se Jezusi vdiq për mëkatet tuaja dhe besoni në fjalët dhe premtimet e Tij dhe kur pagëzoheni për faljen e mëkateve, atëherë jeni ringjallur me Krishtin. Nuk jeni më të vdekur në mëkatet tuaja. Jeni të gjallë në Krisht.

3. *Ai «me Të na vuri të rrimë»*. Ne jemi me Krishtin në vendet qiellore. Me fjalë të tjera, kemi hyrë në një mjedis të ri. Kjo botë nuk është më shtëpia jonë. Ne, kristianët, jetojmë në një vend të ri. Jetojmë në mjedisin për të cilin Perëndia na krijoi. Jezusi erdhi në tokë që ta bënte të mundur këtë. Ai shpesh e quajti këtë mjedis apo vend të ri «mbretëri»:

«Mbretëria ime nuk është e kësaj bote...» (Gjoni 18:36).

«...Atit tuaj i pëlqeu t'ju japë mbretërinë» (Luka 12:32).

«Dhe unë ju caktoj mbretërinë ashtu si ma ka caktuar mua Ati im, që ju të hani e të pini në tryezën time...» (Luka 22:29–30).

«...Nëse një nuk ka rilindur, nuk mund ta shohë mbretërinë e Perëndisë» (Gjoni 3:3).

Kristianët qëndrojnë me Krishtin në vendet qiellore.

Pali na tregon se *çfarë* ka bërë Perëndia. Perëndia «na dha jetë me Krishtin», «na ringjalli me» Krishtin dhe «na vuri të rrimë» me Krishtin. Pali na tregoi, gjithashtu, se *pse* e ka bërë Perëndia gjithë këtë. Pse na ka ringjallur kur meritonim të largoheshim përjetë nga Perëndia?

Përgjigjja nuk gjendet vetëm te vullneti i Perëndisë për të na shpëtuar, për të na sjellë në liri, për të na dhënë jetë apo që të kemi bashkësi (miqësi) me Të. Përgjigjja gjendet edhe në këtë varg: «Për të treguar në epokat që do të vijnë pasurinë e pamasë të hirit të tij, me anë të mirësisë ndaj nesh në Krishtin Jezus» (Efesianëve 2:7).

Përpiquni të kuptoni se *çfarë* pohon ky varg. Perëndia na ka sjellë nga vdekja në jetë në Krishtin që, në ne (kristianët, të shpëtuarit) Ai t'i tregojë gjithë krijimit pasurinë e hirit të Tij. Filloi me kristianët e parë në Jeruzalem dhe vazhdoi me ata në Antioki, Efes, Korint dhe Romë. Arriti te kristianët në shek. II e më pas deri në ditët tona dhe në ditët që do të vijnë, te të gjithë ata që mbajnë

emrin kristian. Gjatë shekujve Perëndia i ka ofruar gjithë krijimit një shfaqje të vazhdueshme të dashurisë dhe hirit të Tij. Në qoftë se i përkisni Krishtit, jeni pjesë e asaj dëshmie të madhe për mrekullinë e hirit të Perëndisë.

Edhe kur kjo botë të mbarojë dhe të jemi me Perëndinë në qiell, ne akoma do të jemi duke lartësuar dhe duke lavdëruar Perëndinë për atë që ka bërë, duke na ringjallur në Krishtin. Në të vërtetë, gjithë engjëjt do të bashkohen në atë lavdërim ndaj Perëndisë për jetë të jetëve.

KONKLUZION

Le të përfundojmë me tri pyetje. Mund t'u përgjigjeni vetë. Në qoftë se pasi t'u jeni përgjigjur të triave do të doni të ndryshoni jetën tuaj, bëjeni këtë menjëherë.

A jeni të vdekur apo të gjallë shpirtërisht? A e jetoni jetën duke qenë me të vërtetë mirënjohës ndaj Perëndisë që ju ka sjellë nga vdekja në jetë? A mund të shikojnë të tjerët ndryshimin e dukshëm që ka bërë Perëndia në jetën tuaj?

Si iu përgjigjët këtyre pyetjeve? Çfarë ndryshimesh keni nevojë të bëni? Perëndia ka fuqinë t'juaj ndryshojë jetën. Lejojeni ta bëjë një gjë të tillë.

Autor: *Rusty Peterman*
Marrë nga seria: "*Efesianëve*"
© 2003 E VERTETA PER SOT
Të gjitha të drejtat të rezervuara